



E K S T R A K T

Nga shënimi zyrtar lidhur me mosmbajtjen e mbledhjes së rregullt të Kuvendit të komunës më 29.03.2011

Rrjedha e procedurës me rastin e mosmbajtjes së mbledhjes së KK-së më datën e cekur më sipër ishte si vijon:

1. Ora 10;10, Kryesuesi i kuvendit konstatoi se në sallë ishin prezent 34 anëtar, mungonte Remzije Isufi të kuvendit – forum i mjaftuar për punë të kuvendit.

2. **Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit**, para propozimit të rendit të ditës, njoftoj kuvendin me vendimin e KQZ mbi zëvendësimin e Sami Istrefit anëtar i KK-së nga subjekti politik i PDK në Vushtrri për shkak të emërimit të tij në postin e Drejtorit për Shërbime Publike në Vushtrri. Në bazë të atij vendimi kandidat i radhës nga i njëjti subjekt politik është z. Hajrullah Muli, të cilin kryesuesi i kuvendit e ftoi që ta jap betimin.

3. Hajrulla Muli dha betimin para anëtarëve të kuvendit të komunës.

4. **Bajram Mulaku, kryetari i Komunës** – njoftoi për ndërrimet kadrovike me ç'rast tha se pas zgjedhjes së Xhevahire Izmaku deputete e kuvendit të Kosovës, e cila ushtronte postin e nënkryetares tani në vend të saj është emëruar Dibran Përçuku (nënkryetar), kurse për drejtor të Drejtorisë për Shërbime Publike është emëruar Sami Istrefi.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit hapi debat lidhur me rendin e ditës.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- tha se kjo mbledhje është thirrur në baza jo ligjore, për shkak se as nuk është thirr si mbledhje e rregullt e as si mbledhje e jashtëzakonshme, dhe shtoi se me këtë është shkelur Statuti aktual i Komunës dhe rregullorja e punës e Kuvendit. Në vazhdim ai propozoi që kjo mbledhje të shtyhet dhe të mbahet ashtu qysh ka qenë e paraparë.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- shprehu pakënaqësinë lidhur me atë se si është thirr kjo mbledhje, pa i konsultuar subjektet e përfaqësuar në Kuvend, dhe shtoi se

kjo mbledhje është thirr në kundërshtim me Statutin, mirëpo edhe pse kjo mbledhje është thirr në këtë formë, ne pajtohemi që kjo mbledhje t'i vazhdoi punimet.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- tha se kjo mbledhje është thirr në kundërshtim me rregulloren e punës së kuvendit, gjithashtu tha se ne si Kuvend Komunal duhet të bëjmë një shkresë që të shprehim pakënaqësitë tona me bisedimet që po zhvillohen në mes të Prishtinës dhe Beogradit, si dhe për përfaqësimin jo të mirë të interesave tona nga ana e delegacionit të Kosovës.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit – kërkoj që të bëhet rekrutimi i kuadrove në spitalin e Vushtrrisë me mjekë specialist dhe atë për 2 gjinekolog, 1 internist, 1 transfuziolog, 1 pediatër, dhe 1 biokimist. Tutje ai arsyetoi se plotësimi i këtyre vendeve do të ndikonte në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, dhe në ruajtjen e imazhit të mirë të Spitalit të Vushtrrisë.

Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit- kërkoj që të informohet Kuvendi lidhur me ecurinë e procesit të regjistrimit në komunën e Vushtrrisë, si dhe për kontrollorët dhe regjistruerit, pasi siç tha ajo ata janë pranuar në bazë të përkatësisë partiake.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se në seanceë e kaluar ka ngritur shqetësimin se në komunën tonë po shitet mish i dyshimtë (i lopëve të sëmura dhe të ngodhura). Tutje ai shtoi se në seancën e kaluar është thënë se në mbledhjen e ardhshme Drejtoria e Inspeksionit do ta informojë Kuvendin lidhur me këtë çështje, mirëpo ne këtë informatë nuk e kemi.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- tha se thirrja e kësaj seance në këtë formë nuk është në pajtim me Statutin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, dhe ne nuk mund të bëhemi pjesë e shkeljes së këtyre akteve. Tutje ai kërkoj që të informohet Kuvendi lidhur me dislokimin e tregut, si dhe pyeti a është caktuar ndonjë lokacion për vendosjen e tij? Mandej pyeti kur është marrë vendim lidhur me këtë, si dhe nga kush, dhe shtoi se a ka pasur transparencë lidhur me këtë.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- propozoi që nënpika “h” në “të ndryshme” të hiqet nga rendi i ditës.

Bajram Mulaku, kryetari i Komunës – arsyetoi se thirrja e kësaj mbledhje më herët se që është e paraparë, është bërë për shkak se kemi një kërkesë urgjente nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, sepse deri më dt.30.03.2011 është afati i fundit për kompletimin e dokumentacionit që duhet të procedohet në Ministri për ndërtimin e parkut të biznesit. Tutje ai njoftoi se sa i përket lokacionit për vendosjen e tregut, është vendosur që ai të vendoset në hapësirat e “ish-ekonomisë së Pyjeve”, dhe se për këtë është shpallur edhe tenderi.

Në përfundim të diskutimit rreth rendit të ditës, Kuvendi me 8 vota “për” dhe 17 “kundër”, të tjerët “abstenim” nuk aprovoi këtë rend dite:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Raporti i punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2010.
3. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit Zonë ekonomike për ndërtimin e parkut të biznesit në fsh. Lummadh.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit të Komunës.
5. Draft-Rregullore për shërbimin e transportit me “merimangë” për territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i parë).

6. **Draft-Rregullore për caktimin e kushteve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i parë).**
7. **Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të tokës në pronësi të Komunës për ndërtimin e objektit për regjistrimin e automjeteve dhe Qendrën e Regjistrimit Civil nga MPB-ja.**
8. **Propozim-vendimi për racionalizimin e ujit të pijes nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit gjatë sezonës verore.**
9. **Propozim-vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve financiare nga të hyrat vetanake prej vitit 2010 në vitin 2011.**
10. **Propozim-vendimi për lejimin e mjeteve financiare nga fondi për bashkëfinancim në vlerë prej 72.407 € për asfaltimin e rrugës “Hamit Hyseni”.**
11. **Propozim-vendimi për përcaktimin e lartësisë së kompensimit të anëtarëve të Komitetit për Auditim të Komunës së Vushtrrisë.**
12. **Propozim-vendimi për anulimin e vendimit të KK-së për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme të komunës.**
13. **Propozim-vendimet për lejimin e mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për:**
 - a. **Blerjen e kohë pas kohshme të gjërave ushqimore për familjet në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.**
 - b. **Bartjen e mjeteve financiare për rindërtim për familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.**
 - c. **Ndihmë për klubet sportive të Komunës së Vushtrrisë.**
 - d. **SHFD-në e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.**
 - e. **OVL-në e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.**
 - f. **SHIL-in e UÇK-së, në shumë prej 3600 €.**
 - g. **Shoqatën e ish të burgosurve politik, në shumë prej 1800 €.**
 - h. **Ndihmë për shërim në vlerë prej 1500 €, për Bajram Pantinën, ish punëtor i Komunës.**
 - i. **Ndihmë për shërim për Arben Mujën, nga Vushtrria.**
14. **Të ndryshme.**

Pas mos aprovimit të rendit të ditës, seanca u ndërpre në ora 10:35.

**Procesmbajtësi
Bastri Duraku**

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**